



Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit Permanent Tribunal of Arbitration

Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit
Oda Ekonomike e Kosovës
Permanent Tribunal of Arbitration
Kosova Chamber of Commerce

Zyra Nr.22, Nëna Terezë, Nr.20,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 780 313
Fax: +381(0) 38 224 299
info@kosovo-arbitration.com
www.kosovo-arbitration.com

TRIBUNALI I PËRHERSHËM I ARBITRAZHIT (“TPA”)

Ftesë për Aplikim për Emërimin e Arbitrave

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) fton persona të kualifikuar shtetas Kosovar për emërimin e arbitrave në Listën e Arbitrave të TPA-së, pranë OEK-ut.

Kualifikimet e kërkuara

- Diplomë universitare dhe kualifikime shtese për të ushtruar profesionin nga fushat e ndryshme praktike relevante për arbitrazhin;
- Eksperiencë profesionale që dëshmon aftësitë e gjykimit të pavarur, vlerësim të drejtë si dhe aplikimin e ligjeve, parimeve biznesore si dhe atyre komerciale;
- Ushtrimin e funksioneve të arbitrazhit në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme, dhe të sigurohen që të gjitha palet të trajtohen në mënyrë të barabartë;
- Zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
- Sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale në pajtim me ligjet e aplikueshme dhe kodin e etikës profesionale;
- Të ruaj nderin dhe dinjitetin e Arbitrit pranë Tribunalit të Arbitrazhit-TPA;
- Të dorëzojë referenca për punën që ndërlidhet me arbitrazhin apo procedurat tjera të ngjashme;
- Vullnet për të marrë pjesë në programin e vazhdueshëm arsimor të organizuar apo të rekomanduar nga Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit-TPA.

Kualifikimet e preferueshme

- Pjesmarrës në organizatat kombëtare apo ndërkombëtare të arbitrazhit, apo të ndonjë institucioni tjetër kredibil i cili ka të bëjë me procedurat tjera gjyqësore apo alternative të zgjidhjes së kontesteve;
- Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;
- Eksperiencë tjetër e ngjashme apo publikimi i artikujve në revistat shkencore dhe/apo profesionale;
- Nderime, çmime apo citime që dëshmojnë leadership në fushën e tij/saj;
- Eksperiencë në procedurat e arbitrazhit, gjyqësore apo ndërmjetësimi;
- Njohja e Gjuhës Angleze.

Po ashtu Oda Ekonomike e Kosovës, duke u bazuar në Aktin e themelimit të TPA-së, fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për Kryesi të Tribunalit të Përhershem të Arbitrazhit. Kryesia e Tribunalit të Përhershme të Arbitrazhit përbëhet prej pesë (5) anëtarëve: Kryetarit të Tribunalit të Përhershem të Arbitrazhit, Nënkryetarit të Tribunalit të Përhershem të Arbitrazhit, Sekretarit të Përgjithshem të Odës Ekonomike të Kosovës i cili zgjidhet me automatizem si dhe dy (2) anëtarë pa ndonjë funksion të veçantë.

Procesi i Aplikimit

- Dorëzimi i CV-së përshtirë të dhënat për punësimin, arsimin, kualifikimet profesionale si dhe dokumentet tjera përcjellëse;
- Dorëzimi i një deklaratë personale e cila nuk tejkalon mbi tre (3) faqe qëllimi i së cilës është të shpjegohet se pse aplikanti duhet të pranohet në listën e arbitrave;
- Dorëzimi i një deklaratë personale e cila nuk tejkalon mbi tre (3) faqe qëllimi i së cilës është të shpjegohet se pse aplikanti duhet të pranohet në Kryesinë e Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit;
- Dorëzimi i dy (2) referencave profesionale.

Ju lutem që dokumentet e juaja të na dergoni vetëm përmes emailit zyrtar: lumnije.hashani@oek-kcc.org

Afati i fundit për aplikim është data 28 Shkurt 2019.

Pas përfundimit të këtij procesi, kandidatët e listuar në listën e ngushtë do të nominohen për t'ju nënshtruar procedurës së emërimit nga Kuvendi i OEK-ut, në pajtim me dispozitat e Aktit Themelues të TPA-së.